

## **Komunikat për medie**

**07.02.2014**

Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) në bashkëpunim me grupin e Grave Deputete me dt. 05.02.2013 organizoi në tryezë me temën „Ligji i Punës dhe niveli i zbatueshmërisë së tijë”. Qëllimi i mbajtjes së kësaj tryeze ishte gjendja aktuale e Ligjit të Punës gjegjësisht gjendja **status quo** e tijë shkak të mos implementimit të Ligjit të Punës edhe me nenet të cilat nuk kërkojnë kosto.

Fukusi i zhvillimit të debatit në këtë tryezë në veqanti ishin:

**-Lidhja e Kontratave të Punës-** edhe pse punëtorët kanë mbushur stazhin e punës më tepër se 10 vite (sipas ligjit kanë fituar të drjetën në kontratë të punës me afat të pacaktuar) ata akoma vazhdojnë të punojnë me kontrata pune me afat të caktuar, duke bërë kështu shkelje të ligjit. Aplikimi i këtij neni nuk kërkon kurrfar kosto financiare gjerësa në vazhdimësi vazhdon që të bëhet shkelja e këtij.

**-Pushimi mjeksor** – me një pushim mjeksor të limituar vetëm në 20 ditë pune, mbrenda vitit kalendarik, konsiderojmë se ky nen është diskriminues, nga arsyeja se as kush nuk mundet me e limituar sëmurjen.

**-Pushimi lehonisë-** tentimi për shkurtimin e tij.

**-Orari i zgjatur i punës** më tepër se 40 orë në javë,

**-Mos pagesa e punës shtesë.**

Konkluzionet:

Në fund të këtij takimi u morrën këto:

### **KONKLUZIONE:**

- Me anë të legjislacionit të tentohet që të bëhet eliminimi i informalitetit në ekonomi,
- Të sigurohet lidhja e kontratave në afat të pacaktuar për ata punëtorë të cilët kanë më tepër se 10 vite ztazh pune,
- Mos të jetë i limituar pushimi mjeksor,
- Të bëhet miratimi i Ligjit mbi Sigurimin Shëndetësor,
- Të bahet rritja e kapaciteteve të inspektoriatit të punës,
- Të bëhen ndryshime në Lgjin e punës ashtu që most ë cunghen të drejtat e punëtorëve,
- Të thjeshtohen procedurat e komplikuara lidhur me pushimin e Lehonisë, Organizimi sindikal edhe në sektorin privat.
- Gjykatat të iu dhanë prioritet rasteve të zgjidhjes së kontesteve të punës.

**Shukrije Regjepi.**